



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 28 gusht 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

Modifikimi i licencave dhe operimi i sistemeve të depozitimit të energjisë elektrike

Bordi miratoi kërkesat e shoqërive:

“POWER ENERGY” sh.p.k., për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 25 MW, në Povelçë, Bashkia Fier, duke njohur dhe lejuar, në kuadër të kësaj licence, operimin e sistemeve të depozitimit të energjisë elektrike të deklaruara nga shoqëria;

“GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 MW, në Ballsh, Bashkia Mallakastër, duke njohur dhe lejuar operimin e sistemeve të depozitimit të energjisë elektrike të deklaruara nga shoqëria;

“IDI 2005” sh.p.k., për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 8.8 MW, në Povelçë, Bashkia Fier, për shtimin e sistemeve të depozitimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin e instaluar;

“Sunny Side Energy” sh.p.k., për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 MW, në Darzezë, Bashkia Fier, për përfshirjen e sistemeve të depozitimit të energjisë elektrike, pa ndryshuar kapacitetin e instaluar.

Në të gjitha këto raste, e drejta për operimin e sistemeve të depozitimit të energjisë elektrike brenda licencës është e vlefshme deri në përfundim të periudhës së përcaktuar në nenin 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, shoqëritë kanë detyrimin të aplikojnë pranë ERE-s për licencë për operimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike.

Fillimi i procedurave të licencimit

Bordi vendosi fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesave të:

“ALBPOWER” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

“EUROTECH INNOVATION” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Helois Energy”, me kapacitet të instaluar 2 MW, në Darzezë, Bashkia Fier, për një periudhë 5-vjeçare. Në kuadër të kësaj procedure, Bordi kërkoi edhe plotësimin e dokumentacionit dhe sqarimeve të nevojshme për vijimin e shqyrtimit të aplikimit.

Pezullimi i vendimmarrjes

Për kërkesën e shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. lidhur me ndryshimin e numrit të paneleve fotovoltaike, Bordi vendosi pezullimin e vendimmarrjes deri në marrjen e sqarimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nëse ky ndryshim përbën ndryshim të parametrave teknikë/energjetikë sipas kontratës dhe nëse kërkohet miratim paraprak nga MIE.

Pezullimi do të zgjasë jo më shumë se 30 ditë nga njoftimi drejtuar MIE-së.

Vijimi i shqyrtimit për “SPV BLUE 2” sh.p.k.

Në lidhje me kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Blue 2”, me synim rritjen e kapacitetit të instaluar nga 50 MW në 100 MW, Bordi vlerësoi nevojën për kryerjen e verifikimeve të mëtejshme.

Çështja do të rikthehet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Bordit, pas administrimit dhe verifikimit të informacionit të nevojshëm.

Në vijim do të zhvillohet korrespondenca me shoqërinë lidhur me kushtet dhe afatet për vënien në operim të kapacitetit shtesë prej 50 MW, në kuadër të projektit të ndryshuar. Gjithashtu, vijon shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me shtimin e veprave ndihmëse dhe sistemeve të depozitimit të energjisë elektrike (BESS).

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s www.ere.gov.al dhe në Fletoren Zyrtare.